



A.nr.87/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.87/2026, të datës 27.01.2026, të parashtruar nga ankuesi SH.O, nga Prishtina, kundër organit të punësimit Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.4, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 13.03.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Detyrohet Ushtruesja e Detyrës së Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të shqyrtoj Kërkesën me numër protokoli 05-9107 të datës 03.12.2025 të parashtruar nga ankuesit SH.O, dhe të nxjerr akt administrativ në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, SH.O (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), me datë 27.01.2026 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të organit të punësimit/Ministries së Shëndetësisë, ndaj Kërkesës me numër protokoli 05-9107 të datës 03.12.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 04.02.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Shëndetësisë, ndërsa kjo e fundit, më datë 11.02.2026 ka dorëzuar përgjigjet në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit)
administroi këto prova: Ankesën me numër protokoli 421/2026 të datës 27.01.2026, të parashtruar nga ankuesi në Këshill; Kërkesën me numër protokoli 05-9107 të datës 03.12.2025; Vendimin me Nr.10/260 të datës 29.05.2025; Vendimin me Nr.238/V/2021 të datës 06.05.2021; Dokument identifikimi i ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 04.02.2026; Përgjigjen në ankesë të datës 11.02.2026; Akt emërimit me numër protokoli 05-4902 të datës 27.06.2025, me përshkrimin e detyrave të punës; Listat e pagave të ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se meqenëse nuk është nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesën e ankuesve, atëherë ekziston baza ligjore që të detyrohet Ushtruesja e Detyrës së Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, të nxjerr akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e Kërkesës me numër protokoli 05-9107 të datës 03.12.2025, të parashtruar nga ankuesi, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi sipas Akt emërimit me numër protokoli 05-4902 të datës 27.06.2025, mbanë pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit të Kujdesit Parësor Shëndetësor, në Departamentin për Shërbime Shëndetësore dhe Shëndet Publik në Ministrinë e Shëndetësisë.

Më tej, nga shkresat e lëndës rrjedhë se sipas Vendimit me Nr.238/V/2021 të datës 06.05.2021, të Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë, ankuesi është caktuar Zëvendësues i detyrës së Kryeinspektorit në Inspektoratin Shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë.

Si rrjedhojë, ankuesi përmes Kërkesës me numër protokoli 05-9107 të datës 03.12.2025, i është drejtuar Ushtrueses së Detyrës së Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore pranë kësaj ministrie, me pretendimin ankimor se gjatë ushtrimit të detyrës të pozitës si Zëvendësues i detyrës së Kryeinspektorit në Inspektoratin Shëndetësor, në periudhën kohore nga data 06.05.2021 deri më 22.12.2022, organi i punëdhënës nuk ka proceduar të njëjti pagesën në përputhje me legjislacionin përkatës, duke mos kompensuar kështu pagën për pozitën e lartë drejtuese të ushtrues, rrjedhimisht ka kërkuar kompensimin e diferencës së pagës për këtë periudhë kohore gjatë ushtrimit të kësaj pozitë, mirëpo nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesi nuk pranuar përgjigje ndaj kësaj kërke.

Ankuesi, si rezultat i heshtjes administrative nga organi i punësimit në raport me Kërkesën me numër protokoli 05-9107 të datës 03.12.2025, ka parashtruar ankesë në Këshill, me pretendimin ankimor se sipas legjislacionit në fuqi pozita e Kryeinspektorit Shëndetësor parashihet si pozitë e lartë drejtuese e nëpunësve civil, dhe në kuptim të ligjit të pagave dhe dispozitave për klasifikimin e vendeve të punës sipas nivelit drejtues, çdo zyrtar publik që ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e një pozite të lartë drejtues ka të drejtën në pagë që i korrespondon koeficientit të asaj pozite, pavarësisht formës së emërimit, si zëvendësim apo ushtrues i detyrës. Rrjedhimisht, thekson se edhe gjatë periudhës kohore nga data 06.05.2021 deri më 22.12.2022, Ministria e Shëndetësisë ka qenë obliguar të aplikojë koeficientin përkatës të pozitës së lartë drejtuese dhe të realizojë kompensimin e diferencës së pagojë kompensimin e diferencës së pagës për periudhën e ushtrimit të faktit të detyrës. Andaj, kërkon aprovimin si të bazuar të

ankesës, gjegjësisht kërkesës për kompensimin e diferencës së pagës, me obligimin që organi i punësimit të ndërmarrë të gjitha veprimet për zbatimin e kësaj kërkesë.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me rregullat e veprimeve procedurale të një organi publik, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (*tutje referuar: LPPA*), përkatësisht nenit 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *2. Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative*, nenit 98 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj*, si dhe nenit 97 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: *1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative*, dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes, Kolegji i Këshillit konstatoi se organi përkatës i punësimit, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat përkatëse ligjore, në raport me Kërkesën me numër protokolli 05-9107 të datës 03.12.2025, të parashtruar nga ankuesi, ngase sipas bazës ligjore si me sipër, vullneti i organit publik në realizimin e autoritetit publik formësohet në procedurë administrative dhe manifestohet në formën e njërit prej veprimeve administrative, siç janë: akti administrativ; kontrata administrative apo akti real, dhe se në vlerësimin e Kolegjit, organi përkatës i punësimit, në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, është dashur që të nxjerr akt administrativ në kuptim të vendosjes dhe të njoftoj palën për aktin e tillë, brenda një afati prej 45 ditësh sikurse përcaktohet me nenin 98 paragrafi 2 apo afatit të vazhduar sipas nenit 99 paragrafi 1 të LPPA-së.

Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, heshtja e organit të administratës, në këtë rast, Ushtruesja e Detyrës së Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë në raport me Kërkesën me numër protokolli 5-9107 të datës 03.12.2025, cenon të drejtat e ankuesit në kuptimin e të drejtave procedural dhe për rrjedhojë edhe vendosjes në mënyrë meritore, ngase ashtu sikurse është thënë në arsyetim të këtij vendimi, në kërkesën e parashtruar tek organi i punësimit, ankuesi pretendon realizimin e kompensimit material të diferencës së pagës për pozitën e ushtruar sipas Vendimit me Nr.238/V/2021 të datës 06.05.2021, të Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë, ku ankuesi është caktuar Zëvendësues i detyrës së Kryeinspektorit në Inspektoratin Shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë, përkatësisht kompensimin për periudhën kohore nga data 06.05.2021 deri më 22.12.2022.

Kështu që thënë si me sipër e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi të aprovoj si të bazuar ankesën e datës 27.01.2026, në kuptim të shkëlqeve procedurale, dhe si rrjedhojë detyroj Ushtruesen e Detyrës së Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, që në respektim të dispozitave procedurale të shqyrtoj Kërkesën me numër protokolli 055-9107 të datës 03.12.2025, të parashtruar nga ankuesi dhe të nxjerr akt administrativ në përputhshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.87/2026

Atdhe GASHI

Malsore GASHI-BAJRATARI

Procesmbajtës

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit SH.O;
- U.D Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë; si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.